REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr……. Prot. Tiranë, më .................2016

**PLANI MËSIMOR ARSIMI I MESËM I ORINETUAR, (GJUHËT E HUAJA) )[1], VITI SHKOLLOR 2016 – 2017**

**MIRATOHET**

**MINISTËR**

**LINDITA NIKOLLA**

| Nr. | Fushat e të nxënit/Lëndët | Shkalla5 | | Shkalla 6 |
|---|---|---|---|---|
| | | Klasa X | Klasa XI | Klasa XII |
| **I.** | **GJUHËT DHE KOMUNIKIMI** | **12** | **12** | **12** |
| I.1 | Gjuhë shqipe | 2 | 2 | 2 |
| I.2 | Letërsi | 2 | 2 | 2 |
| I.3<br>I.4 | Gjuhë e huaj e parë<br>Gjuhë e huaj e dytë | 4<br>4 | 4<br>4 | 4<br>4 |
| **II.** | **MATEMATIKË** | **3** | **3** | **3** |
| **III.** | **SHKENCAT E NATYRËS** | **6** | **0** | **0** |
| III.1 | Fizikë | 2 | 0 | 0 |
| III.2 | Kimi | 2 | 0 | 0 |
| III.3 | Biologji | 2 | 0 | 0 |
| **IV.** | **SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **5** | **5** | **0** |
| IV.1 | Qytetari | 2 | 0 | 0 |
| IV.2 | Filozofi | 0 | 2 | 0 |
| IV.3 | Histori | 1 | 2 | 0 |
| IV.4 | Gjeografi | 2 | 1 | 0 |
| **V.** | **TEKNOLOGJI DHE TIK** | **1** | **2** | **0** |
| V.1 | TIK | 1 | 2 | 0 |
| **VI.** | **EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET** | **2** | **2** | **2** |
| | **KURRIKULA BËRTHAMË** | **29** | **24** | **17** |

[1]Ky plan mësimorfillontëzbatohetpërherëtëparënëvitinshkollor 2016-2017, nëklasën e dhjetë.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **KURRIKULA ME ZGJEDHJE** | **2** | **3** | **13** |
| | **KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE**[2] | **0-2** | **0-2** | **0-2** |
| | **TOTALI (ORË MËSIMORE/JAVË)** | **31- 33** | **29-31** | **30--32** |

**Kurrikula me zgjedhje të detyruar**

| **Nr** | **Fushat e të nxënit/Lëndët** | **Kl. 10** | **Kl. 11** | **Kl. 12** |
|---|---|---|---|---|
| **I.** | **GJUHËT DHE KOMUNIKIMI** | **2** | **2** | **4** |
| I.1 | Letërsi | | | **2** |
| I.2 | Gjuhë e huaj (Nivel i avancuar) | 2(A) | 2(A) | **2(A)** |
| **II.** | **SHKENCAT E NATYRËS** | **0** | **0** | **6**[3] |
| II.1 | Fizikë | 0 | 0 | 2(B) |
| II.2 | Kimi | 0 | 0 | 2(B) |
| II.3 | Biologji | 0 | 0 | 2(B) |
| **III.** | **SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **0** | **0** | **12** |
| III.1 | Shkenca Sociale (Sociologji, Psikologji) | 0 | 0 | 2 +2 |
| III.2 | Histori | 0 | 0 | 4 |
| III.3 | Gjeografi | 0 | 0 | 4 |
| III.4 | Ekonomi | 0 | 0 | 2 |
| **IV.** | **TEKNOLOGJI DHE TIK** | 0 | 0 | 0 |
| IV | TIK | 0 | 1 | 4 |
| **V** | **ARTE ( drame, muzikë, art pamor)** | 2 | 2 | **2** |
| **VI** | **EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET** | 1 | 1 | **1** |
| **VII** | **MODULE KURRIKULARE** | 2 | 2 | **Max8**[4] |

[2]Brenda hapësirëssëkurrikulësnëbazëshkollezhvillohetdheshërbimikomunitar. Shërbimikomunitarështëidetyruartëkryhetnë 18 orë, nëklasën e 10-tëdhe/osenëklasën e 11-të.Orët e tjeratëkurrikulësnëbazëshkollenukjanëtëdetyruara, atoimundësojnëshkollëszbatimin e kurrikulëslidhur me projektendërkurrikulare, përforcime, veprimtaritë e tjerashkollore.

[3]Lëndët Fizikë, Kimi dhe Biologji do të zhvillohen me programin e kurrikulës bërthamë.
[4]Modulet kurrikulare mund të jenë module profesionale që zhvillojnë tek nxënësi aftësi të nevojshme për tregun e punës ose module që zhvillojnë tema ndërkurrikulare.

**KURRIKULA ME ZGJEDHJE NË BAZË SHKOLLE**

| **Nr.** | **Fushat** | **Lënda/ Module lëndore dhe profesionale/projekte** | **Klasa X** | **Klasa Xl** | **Klasa Xll** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Arte | Fotografi-fotoshop | 1 orë | 1 orë | 1 orë |
| 2 | Gjuhët dhe komunikimi | Përkthim-Gjuhë e huaj | 1 orë | 1 orë | 1 orë |
| 3 | Shoqëria dhe mjedisi | Guidë turistike | 1 orë | 1 orë | 1 orë |
| 4 | Shoqëria dhe mjedisi | Nryshimet klimeterike | 1 orë | 1 orë | 1 orë |
| 5 | Edukim fizik dhe sporte | Lojëra sportive | 1 orë | 1 orë | 1 orë |
| 6 | | Projektetshkollore | 1 orë | 1 orë | 1 orë |

**KOMENTE**

**Plani mësimor i gjimnazit me orientim gjuhësor është hartuar duke u bazuar në:**
- koherencën me reformën e kurrikulës bazuar në kompetenca në arsmin bazë;
- orientimin e politikës arsimore të shtetit për përdorimin e teksteve angleze në lëndët e matematikës dhe shkencave të natyrës;
- traditën dhe përvojën pozitive të gjimnazit aktual;
- në studime të IZHA-s lidhur me zbatimin e kurrikulës aktuale në gjimnaz;
- respektimin e të drejtës së nxënësit për zgjedhje sipas niveleve, interesave dhe nevojave që ai ka për karrierën e tij (në tregun e punës apo në studimet e arsimit të lartë);
- fleksibilitetin në ofrimin e kurrikulës me zgjedhje nga shkolla;
- lehtësimin e menaxhimit të kurrikulës nga shkolla.

**Struktura e kurrikulës**
Në këtë draft, kurrikula është e organizuar në:
- kurrikul bërthamë;
- kurrikul me zgjedhje në bërthamë;
- kurrikul me zgjedhje;

duke synuar uljen e ngarkesës për nxënësit dhe duke e orientuar atë drejt prirjeve dhe interesave të tij.

**Kurrikula bërthamë** në **klasën e 10 synon një përafrim me kurrikulen e gjimnazit duke pasur synim dhe kalimin e nxënësve nga njeri tip shkollimi në tjetrin .**

**Në klasën e 11** është reduktuar ngarkesa ne shkencat e natyrës dhe kjo mundësi jepet si zgjedhje ne klasën e 12; në **klasën e 12**, nxënësit mund të zgjedhin këto lëndë brenda kurrikulës bërthamë dhe me programet mesimore përkatëse .

**Kurrikula me zgjedhje** ofrohet në të tria klasat, por ajo vjen duke u rritur në klasën e 12, ku ka një përqindje të konsiderueshme të orëve. Kurrikula me zgjedhje fokusohet në zgjedhjen e lëndëve qe orjentojë këtë tip shkollimi dhe moduleve profesionale që nuk zhvillohen në bërthamë. Në kurrikulën me zgjedhje shkolla ofron edhe shërbimin komunitar.

**Viti mësimor** do të zgjasë 36 javë për klasën 10 dhe 11, ndërsa zgjat 34 javë për klasën e 12.

**Java mësimore** ka 30-32 orë mësimore. 30 orë në javë shkolla detyrimisht i plotëson me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje, ndërsa 2 orë të tjera i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore. Nxënësi ka detyrimin të zhvillojë 30 orë në javë për secilin vit shkollor si dhe 18 orët e shërbimit komunitar. Orët e shërbimit komunitar nxënësi i plotëson në hapësirën e kurrikulës në bazë shkolle. Shërbimi komunitar kryhet në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të.

**Shpjegime për secilën klasë:**

- **Klasa 10** ka 29 orë kurrikul bërthamë që zhvillohen në 14 lëndë (Gjuha Shqipe dhe Letërsi llogaritet 2 lëndë), ndërsa kurrikula me zgjedhje ka 2 orë, në të cilën mund të zhvillohen lëndë/module kurrikulare.
- **Klasa 11** ka 25 orë bërthamë, të cilat zhvillohen në 11 lëndë (Gjuha Shqipe dhe Letërsi llogaritet 2 lëndë) dhe 3 orë kurrikul me zgjedhje në të cilën mund të zhvillohen lëndë/module kurrikulare.
- **Klasa 12** ka 17 orë kurrikul bërthamë e cila zhvillohet në 5 lëndë. Numri i orëve varion sipas zgjedhjeve të programeve A dhe B që nxënësit do të zgjedhin në lëndën Gjuhë e huaj dhe shkenca natyrore. Kurrikula me zgjedhje ka 14 orë në të cilat mund të zhvillohen lëndë/module kurrikulare.
- **Shërbimi komunitar** është i detyruar të kryhet në 18 orë. Ai mund të kryhet në klasën e 10 dhe/ose në klasën e 11. Orët e shërbimit komunitar nxënësi i plotëson në hapësirën e kurrikulës në bazë shkolle.
- **Modulet kurrikulare** në kurrikulën me zgjedhje mund të kryhen në ato raste kur shkolla ka mundësi që t'i ofrojë dhe në rast se nxënësi ka interes për to. Në rast të kundërt ato mund të plotësohen me lëndë të tjera nga kurrikula me zgjedhje. Modulet kurrikulare mund të jenë 1 ose 2 orë në javë.